



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS
SË BIZNESIT

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2019

Lënda: Kthim përgjigje.

Blv. _____, Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 318 datë 06.05.2019 për informacion rreth zonës së Thethit, së pari ju urojmë punë të mbarë dhe realizim të objektivave që keni vendosur.

Bashkia Shkodër ka në dispozicion të dhënat bazë statistikore të territorit të bashkisë, nëpërmjet të cilave planifikohen dhe analizohen situatat, shërbimet që duhen ofruar si dhe ndërhyrjet e nevojshme.

Duke marre parasysh ndryshimet demografike të viteve të fundit, flukse të brendshme dhe të jashtme migratore, analizimi i të dhënave të territorit mbetet një nevojë e vazhdueshme por që paraqet një vështirësi të lartë për të gjitha institucionet Shqiptare.

Zona e Thethit është një zonë me prioritet të veçantë për Bashkinë e Shkodërs por edhe për të gjithë Shqipërinë. Kjo zonë është pjesë e Parkut Kombëtar dhe si e tillë, përveq administrimit të shërbimeve nga ana e Bashkisë, merr vëmendje të veçantë nga institucioni i AKZM (Agjencia Kombetare e Zonave të Mbrojtura) si dhe nga Fondi Shqiptarë i Zhvillimit, të cilat me mbështetjen e nevojshme financiare dhe me burime njerëzore kanë realizuar edhe studime të detajuara të zhvillimit të këtyre zonave.

Ne kuadër të kërkesave tuaja, ju informojmë që përveq të dhënave tona të cilat mund ti gjeni në faqen internetit të Bashkisë Shkodër, informacion më të detajuar dhe specifik mund të gjeni në dokumentet e Planit Kombëtarë Sektorial të Turizmit Rajoni i Alpeve Shqiptarë, pranë faqes së Fondit Shqiptarë të Zhvillimit, në dokumentet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Raportit të Analizës së Përgjithshme:

<https://www.albaniandf.org/2018/02/02/plani-kombetar-sektorial-i-turizmit-rajoni-i-alpeve-shqiptare/>

Suksese në punën Tuaj.

KRYETAR

Voltana Ademi